



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:233776

Datë: 01.02.2022

Numri i dokumentit: 02664357

PKR.nr. 222/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, Kryetari i Trupit Gjykes, Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështjen penale kundër të pandehurit E.G., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 275 par.1, nënpar.1.7, të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.210/21, të dt. 29.12.2021, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar të datës 14.01.2022, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Sahide Gashi, të pandehurit E.G., dhe mbrojtësit të tij av. G.K., sipas autorizimit, ne te njëjtën dite merr dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 01.02.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

E.G., i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në, ku edhe banon në rr., identifikohet në bazë të lnj.nr....., ka të kryer shkollën fillore, i pamartuar, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, posedues i tel.nr., shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, në paraburgim nga dt. 18.10.2021, deri me dt. 14.01.2022, tani mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 18.10.2021, rreth orës 12:40, në Pejë, në afërsi të Shkollës së Mesme, pa autorizim posedon me qëllim të shitjes së substancave, të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që derisa ishin duke kaluar aty pari Njësitit i Kufitar “Perëndimi” –Gjakovë, nga Stacioni Radavc-Vitomiricë, konkretisht: Kapiten A. Z., Toger A. H. dhe Xh. J.- këtu dëshmitarë, disa nxënës të kësaj Shkolle u ofrohen dhe i njoftojnë se i pandehuri pasi kishte lëvizur afër Shkollës, i kishte kanosur me thikë dhe kur policët në fjalë tentojnë ta ndalojnë të njëjtin, ai merr

arratinë në drejtim të Emergjencës së Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, gjersa policia i vihet në ndjekje, të cilët vërejnë se si i pandehuri gjatë ikjes e hudhë një çantë që e kishte me vete në rrjedhjen e ujit, mirëpo pasi edhe me ndihmën e qytetarëve arrijnë të njëjtin ta ndalojnë, gjatë kontrollit, në xhepin e pasëm të pantallonave ia gjejnë dhe sekuestrojnë një thikë, gjersa pasi e hapin çantën që e kishte hudhur në prezencën e tij, vërehet se në të njëjtën kishte 31 mbështjellës me folje me narkotik, menjëherë njoftojnë Njësitin përkatës, të cilët pasi të njëjtat i sekuestrojnë, së bashku me të hollat që i kishte me vete, në shumë prej 88.00 (tetëdhjetë e tetë) eurosh, me rastin e ekzaminimit me Nar Test 2000, të substancës në fjalë, rezulton se në mbështjellës kishte narkotik të llojit ‘Marihuanë’, secila prej qeseve me nga 0.021gr, e me peshë të përgjithshme prej 34.8gr.

-me çka ka kryer veprë penale blerja posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotike, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 275 par.1, nënpar.1.7, të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 72, par.1, nënpar.1.3, 267 par.1, lidhur me nenin 275 par.1, nënpar.1.7, të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-se, të pandehurin e:

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar, që të paguajë në afat prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, dhe

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 18.10.2021 e deri me dt. 14.01.2022, i pandehuri dënimin me burg do ta mbajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të caktuar si më lartë, atëherë dënimi me gjobë do ti shëndrohet në dënim me burg, duke llogaritur 1(një) ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor shumen prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 267 par.5, të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet narkotiku i llojit Marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 34.8 gr, narkotiku, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi duhet të shkatërrohet.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë, PP/L.nr.77/21, të dt. 30.03.2021, kundër të pandehurit E.G., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 275 par.1, nënpar.1.7, të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 14.01.2022, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar ku prezent ishin Prokurorit të Shtetit, Sahide Gashi, i pandehuri E.G., dhe mbrojtësi i tij av. G.K., sipas detyrës zyrtare.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta, dhe se për mbrojtës ka angazhuar, avokatin G.K., sipas autorizimi.

Pas leximit të aktakuzës, nga prokurori i shtetit, kryetari i trupit gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri E.G., deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka shtuar se ndihet i penduar, dhe premtun se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, do të punon me prindin tij dhe do të largohet prej rrugëve të këqija.

Mbrojtësi i të pandehurit E.G., av. G.K., deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin e tij dhe pasi që i njëjti i ka kuptuar të gjitha kufizimet dhe privilegjet të cilat rrjedhin prej pranimin të fajësisë, i njëjti me vetë dëshirë ka bërë pranimin e fajësisë, duke shprehur keqardhje të madhe dhe duke premtuar se kjo në të ardhmen assesi nuk do të përsëritet siç tha edhe vet kjo kohë që ka qëndru në paraburgim ia ka hapur sytë që i njëjti edhe si përdorues i substancave narkotike më asnjëherë mos të përdor dhe mos të bëjë asnjë veprim tjetër në lidhje me narkotik, andaj duke marr parasysh këto rrethana moshën e të njëjtit, si dhe pranimin e fajësisë, si dhe faktin se i njëjti këto ditë do ta zyrtarizon edhe martesën me të fejuarën e tij, kërkon nga kjo gjykatë që të gjitha këto ti merr si rrethana posaçërisht lehtësuese dhe duke bazuar në dispozitat e nenit 71 dhe 72 të KPP-së të cilat kanë të bëjnë me zbutjen e dënimeve të njëjtit ti shqiptohet nën minimumin e paraparë me ligj për këtë vepër penale.

Prokurori i shtetit, deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka përputhje me të gjitha provat me të cilat është mbështetur kjo aktakuzë, ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese ia lë gjykatës, ndërsa rënduese të merren parasysh rrezikshmëria e madhe që paraqet kjo vepër për shëndetin dhe jetën sidomos shtresës më të ndjeshme të shoqërisë, përhapjes së madhe të këtyre veprave kohëve të fundit.

Kryetari i Trupit Gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton

natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë : Raporti fillestar i incidentit nr. ..., i dt. 18.10.2021, Raport i oficerit R. P. i dt. 18.10.2021, Raporti i oficerit Xh. J. i dt. 18.10.2021, Deklarata e të dyshuarit E.G. dhënë në polici me dt 18.10.2021, si dhe ajo e dhënë pranë kësaj prokurorie më dt. 15.11.2021, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve më nr. ... i dt. 18.10.2021, Raporti informues i dt. 18.10.2021, nr Ref .., Procesverbal për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm i dt. 18.10.2021, Raporti i analizës së narkotikëve me nr. ... i dt. 18.10.2021, Fotoalbumi i rastit, si dhe shkresat tjera te lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit E.G., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 275 par.1, nënpar.1.7, të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer dhe premtimin se ne të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti. Gjykata pati parasysh faktin se i pandehuri edhe me parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale, mirëpo meqenëse i njëjti këto vepra penale i kishte kryer si i mitur gjykata për këtë arsye nuk ja llogariti si rrethana rënduese.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 50 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me konfiskimin e sendit është marr në kuptim të nenit 267 par. 5 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.222/21 dt. 01.02.2022

Sekretarja Juridike
Fitore Bojku

Kryetari i Trupit Gjykses
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.